

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6844
E enjte, 9 mars 2023
çmimi 0.40 €

Qeveria do të shpallë
konkurs ndërkombëtar
për kompleksin
"Adem Jashari" | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

POLICIA E KOSOVËS BËHET ME DREJTOR TË PËRGJITHSHËM | FAQE 4-5



Pas më shumë se gjysmë viti prej kur Policia e Kosovës udhëhiqet nga një ushtrues detyre, në mbledhjen e

qeverisë është votuar drejtori i ri i përgjithshëm i Policisë. Gazmend Hoxha, pozita e të cilit është kolonel, është

emëruar të mërkurën në krye të institucionit kyç të sigurisë në Kosovë, Policinë e Kosovës

AKTUALE



OBSH-ja: MIJËRA NJERËZ
NË UKRAINË KANË LËNDIME
KOMPLEKSE QË LIDHEN ME
LUFTËN | F. 2

EDHE NË KOSOVË FESTOHET 8
MARS, LIDERËT INSTITUCIONALE
PËR BARAZI GJINORE | F. 6

KUVENDI S'KA KUORUM PËR
VOTIMIN E TRI MARRËVESHJEVE
NDËRKOMBËTARE | F. 4

HARADINAJ: PLANI EVROPIAN
PËRFSHIN EDHE NJOHJEN | F. 5

EKONOMI



QEVERIA VAZHDON
T'I SUBVENCIONOJË KURSIMITARËT
E ENERGJISË | F. 8

SPORT



ÇEKU: FFK-ja ENDE KA PUNË PËR
LËCENCIM, S'KA RREZIK TË
PËRJASHTOHEMI NGA FIFA E UEFA | F. 10

VITIA
PARALAJMËRON
PUNËSIMIN
EDHE TË 42
INSPEKTORËVE
SHËNDETËSORË | FAQE 5



QEVERIA
IA VAZHDON
MANDATIN
DREJTORIT TË
AGJENCISË SË
KOSOVËS PËR
AKREDITIM | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OBSH-ja: Mijëra njerëz në Ukrainë kanë lëndime komplekse që lidhen me luftën

GJENEVE, 8 MARS - Mijëra njerëz në Ukrainë kanë pësuar lëndime komplekse të lidhura me luftën dhe kanë nevojë për shërbime rehabilitimi dhe pajisje për t'i ndihmuar, tha Satish Mishra, zyrtar i lartë i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Mishra, nga Zyra Rajonale e OBSH-së për Evropën, tha më 7 mars se lëndimet përfshijnë fraktura, amputime, lëndime të shtyllës kurrizore, lëndime traumatike të trurit dhe djegie. Ai shtoi se sulmet në objektet e kujdesit shëndetësor, më pak punonjës për shkak të zhvendosjes dhe mungesës së energjisë elektrike, po e bëjnë më të vështirë për njerëzit që të marrin shërbimet e nevojshme. Në nëntor të vitit të kaluar,

presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky e quajti Rusinë "shtet terrorist" që bën "terror dhe vrasje", pasi një foshnjë u vra në një repart të maternitetit pas një sulmi me raketa, në një spital në pjesën jugore të Zaporizhjas. Ai tha se që nga nisja e luftës Rusia ka hedhur rreth 5 700 raketa në Ukrainë. Bombardimet dhe sulmet me raketa ruse kanë goditur infrastrukturën civile në pjesë të ndryshme të Ukrainës. Si rrjedhojë, mijëra njerëz janë plagosur dhe miliona ukrainas kanë mbetur pa energji elektrike. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022. Presidenti rus, Vladimir Putin, e konsideron luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar



Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur

ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra

persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Ukraina mohon raportimet e NYT se sabotoi gazsjellësin

KIEV, 8 MARS - Ukraina ka përsëritur se nuk ishte e përfshirë në sabotimin e gazsjellësit Rrjedha Veriore pavarësisht prej raporteve të medieve se inteligjenca e analizuar nga zyrtarët amerikanë ka thënë se një grup pro-ukrainas qëndronte pas sulmeve të vitit të kaluar. Më 7 mars gazeta "New York Times" (NYT) raportoi se, sipas inteligjencës amerikane, një grup pro-ukrainas ka qenë pas sulmit të shtatorit në tubacionet që hodhën gaz në Detin Baltik. Sipas Suedisë dhe Danimarkës, tubacionet që transportonin gaz natyror nga Rusia në Gjermani u shkatërruan qëllimisht në zonat ekskluzive ekonomike ku ndodhën shpërthimet. Megjithatë, është ende e paqartë se kush mund t'i ketë urdhëruar sulmet dhe cilët janë autorët. Shpërthimet dëmuan rëndë Rusinë sa i përket mundësisë për të eksportuar gaz natyror në Perëndim për të gjeneruar të ardhura gjatë pushtimit të paprovokuar të



Ukrainës. "Ky nuk është akti ynë" u tha gazetarëve më 8 mars, në kryeqytetin suedez, Stokholm, ministri ukrainas i Mbrojtjes, Oleksiy Reznikov, përpara një takimi me ministrat

e mbrojtjes të BE-së. Një ditë më parë, këshilltari presidencial Mykhaylo Podolyak mohoi çdo përfshirje zyrtare në incident, duke shtuar se qeveria nuk kishte

informacion në lidhje me "grupet pro-ukrainase" që mund të ishin përfshirë. Në shtator katër shpërthime shkaktuan rrjedhje në tri nga katër lidhjet që përbëjnë tubacionet e Rusisë Rrjedha Veriore 1 dhe 2, duke lëshuar tonelata gaz metan nën presion në Detin Baltik. Kjo ndodhi në një kohë kur shqetësimet në Evropë për një krizë të mundshme energjetike të shkaktuar nga ndërprerjet në furnizimin rus si rezultat i konfliktit të saj të vazhdueshëm me Ukrainën ishin në nivelin më të larta të të gjitha kohëve. I ndërtuar nga kompania e kontrolluar nga shteti rus, "Gazprom", gazsjellësi Rrjedha Veriore lidh Rusinë me Gjermaninë. Një prokuror suedez ka thënë se në vend u gjetën gjurmë eksplozivi. NYT raportoi se rishikimi i inteligjencës sugjeroi se ata që kryen sulmet kundërshtojnë presidentin rus Vladimir Putin, "por nuk specifikohen anëtarët e grupit, apo se kush i ka urdhëruar apo paguar për operacionin".

Sipas medieve gjermane, grupi të cilin NYT nuk e përmendi, përbëhej nga gjashtë individë të cilët morën me qira një varkë nga qyteti port i Rostock dhe përdorën pasaporta të rreme për ta bërë këtë. Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, tha më 8 mars se nuk duhet të jepen konkluzione të shpejta rreth këtij incidenti. "Mund të ketë qenë po aq një operacion i rremë i organizuar për ta fajësuar Ukrainën, një opsion i përmendur edhe në raportet e medieve... Gjasat për njërin apo tjetrin janë po aq të larta", tha Pistorius në një intervistë për transmetuesin publik "Deutschlandfunk". Shtetet e Bashkuara dhe NATO-ja i quajtën sulmet e shtatorit të vitit 2022 ndaj gazsjellësit nën Detin Baltik, "akt të sabotimit", përdërisa Moskë fajësoi Perëndimin. Asnjëra palë nuk ofroi dëshmi për akuzat e tyre. Në anën tjetër, Rusia muajin e kaluar kërkoi nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara që të kryejë një hetim të pavarur.

Baerbock i bën thirrje Iranit t'i ndalë sulmet ndaj territorit irakian

Bagdad, 8 mars - Ministria e Jashtme gjermane Annalena Baerbock i bëri thirrje Iranit që t'i ndalë sulmet me raketa ndaj territorit irakian. Kryediplomatja gjermane i bëri këto deklarata gjatë vizitës në Bagdad të Irakut. "Regjimi iranian tregon se me sulmet

me raketa nuk po shtyp vetëm popullin e tij përmes brutalitetit, por duket se është i përgatitur të rrezikojë jetën dhe stabilitetin në mbarë rajonin për të qëndruar në pushtet", tha Baerbock pas takimit me homologun e saj irakian Fuad Hussein.

Ajo tha se "kjo është krejtësisht e papranueshme dhe e rrezikshme për rajonin si tërësi. Kryediplomatja gjermane shtoi se Karta e Kombeve të Bashkuara në mënyrë specifike ndalon sulmet e tilla dhe kërkon që sovraniteti i shteteve të tjera të respektohet.



Qeveria do të shpallë konkurs ndërkombëtar për kompleksin “Adem Jashari”

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 MARS - Qeveria e Kosovës do të investojë për kompleksin memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe për këtë do të shpallet një konkurs ndërkombëtar. Në mbledhjen e ekzekutivit mbajtur të mërkurën është miratuar vendimi për aprovimin e kriterëve, kushteve për shpalljen e konkursit si dhe procedurat e aplikimit të përzgjedhjes së projektit për kompleksin memorial “Adem Jashari”.

Ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ka dhënë shumë hollësi në mbledhjen e qeverisë. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se si qeveri e kanë trajtuar me prioritet të lartë dhe kujdes të veçantë Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz. “Që prej themelimit të Komitetit

Ndërministror më 2021, vetëm një muaj pas formimit të qeverisë, kemi ecur me hapa të sigurt drejt mbrojtjes së vlerave dhe zhvillimit të master-planit për Kompleksin Memorial. Vitin e kaluar jemi kujdesur që të konsolidohet gjendja fizike e ndërtesave në këtë kompleks e falë ndërhyrjeve emergjente, gjendja e sigurisë së ndërtesave të rrezikuara brenda kompleksit është përmirësuar. Kompleksi Memorial është pasqyrë e jona, pasqyrë në të cilën e shohim veten tonë përmes së cilës na shohin të tjerët. Aty e gjejmë lavdinë e djeshme, forcën për nesër”, ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se me këtë projekt do të jetësohet vizioni i përbashkët i përfaqësimit të drejtë e të duhur të historisë heroike, sakrificës së papërsëritshme dhe kontributi i pashoq i familjes Jashari për çlirimin e vendit tonë.



Policia e Kosovës bëhet me drejtor të përgjithshëm



Pas më shumë se gjysmë viti prej kur Policia e Kosovës udhëhiqet nga një ushtrues detyre, në mbledhjen e qeverisë është votuar drejtori i ri i përgjithshëm i Policisë. Gazmend Hoxha, pozita e të cilit është kolonel, është emëruar të mërkurën në krye të institucionit kyç të sigurisë në Kosovë, Policinë e Kosovës. Ky i fundit deri më tani ka mbajtur pozitën e drejtorit në Departamentin për Operacione pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (DPP)

PRISHTINË, 8 MARS - Gazmend Hoxha është emëruar drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Ky vendim është marrë më 8 mars, në mbledhjen e qeverisë, e cila miratoi rekomandimin e ministrit të Brendshëm, Xhelal Sveçla, për ta zgjedhur atë në krye të Policisë.

Zëvendësministri i Brendshëm,

Bardhyl Dobra, tha në mbledhjen e ekzekutivit se për këtë pozitë kanë aplikuar pesë kandidatë, prej të cilëve tre kanë hyrë në listën e ngushtë. Përveç Hoxhës, në garë ishin edhe Granit Fetahu dhe Bahri Shala. Në gusht të vitit të kaluar drejtori i PK-së, Samedin Mehmeti, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Arsyeja e dorëheqjes së tij lidhej me “arsye personale dhe ndërgjegje profesionale” pas rastit të dhunimit të një 11-vjeçeje në Prishtinë.

Më pas, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kishte caktuar ushtrues detyre të drejtorit të përgjithshëm, Fehmi Hotin, zëvendësdrejtor i PK-së.

Që nga viti 2000 e deri më sot Hoxha ka kaluar në pothuajse të gjitha gradat dhe pozitat policore, përveç asaj të drejtorit të përgjithshëm dhe të zëvendësdrejtorit.

Hoxha në vitin 2020 mori pozitën e shefit të operacioneve, të cilën e ushtroi për më shumë se dy vjet. Një vit para se drejtori i ri i policisë ta merrte këtë pozitë, në vitin 2019 ai kishte shërbyer si drejtor i Divizionit për Siguri Publike. Para kësaj, për shtatë vjet radhazi, nga 2012-ta, Hoxha, duke e mbajtur pozitën e nënkolonelit, kishte

ushtruar detyrën e drejtorit rajonal në Ferizaj, pozitë të cilën e kishte ushtruar edhe në një pjesë të vitit 2009, në kohën kur Hoxha kishte gradën e majorit. Paraprakisht, përgjatë 2011-s, në Policinë e Kosovës ai shërbente si ndihmësdrejtor i përgjithshëm i policisë për hetime, përderisa një vit më herët në gradën e majorit ai kryente punën si kryesues në Departamentin Kundër Krimin të Organizuar. Përpos pozitës së drejtorit rajonal në Ferizaj, gjatë 2009-s Hoxha kishte shërbyer edhe si drejtor policor i njësive speciale. Ai për dy vjet, 2006-2008m kishte punuar në Gjilan si zëvendësdrejtor rajonal për hetime dhe përgjatë asaj kohe mbante gradën e majorit, përderisa më 2005, në gradën e kapitenit, Hoxha kishte shërbyer komandant i Stacionit Policor Veriu në Prishtinë.

Më 2002, 2003, 2004 Hoxha punën e tij të përditshme e kishte kryer në Stacionin Policor Jugu në kryeqytet. Më 2002 kishte shërbyer si mbikëqyrës ndërrimi në gradën e rreshterit, gradë të cilën e mbajti edhe gjatë 2003-s kur shërbente në pozitën e mbikëqyrësit të Njesisë Mbështetëse Operative, për t'u graduar një vit më vonë, më 2004, në pozitën e togerit.

Qeveria ia vazhdon mandatin drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim

Prishtinë, 8 mars - Qeveria Kurti ia ka zgatur mandatin drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Naim Gashi. Propozimi për zgjatjen e mandatit ka ardhur nga

Ministria e Arsimit, bazuar në performancën dhe punën e tij të mirë në këtë institucion. “Propozim-vendimi për rizgjatjen e mandatit të AKA-së në kuadër të MASHTI-t. Kjo vjen bazuar në performancën

e treguar nga Gashi dhe vlerësuar nga Ministria e Arsimit”, ka thënë kryeministri Albin Kurti. Ndërsa zëvendësministria e Arsimit, Edona Maloku, ka thënë se gjatë tri vjetëve të mandatit të

tij Gashi ka pasur performancë të mirë në AKA. Më pas, ky propozim-vendim është miratuar në mbledhjen e qeverisë, ku nuk ka pasur asnjë votë kundër apo abstenim.



Haradinaj: Plani evropian përfshin edhe njohjen

PRISHTINË, 8 MARS - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, është shprehur i bindur se në planin evropian përfshihet edhe njohja e Kosovës, teksa ka thënë se subjekti politik që ai drejton do të votojë pro kësaj marrëveshjeje. Ai ka thënë se koha është faktor kyç për Kosovën, e nëse marrëveshja arrihet brenda këtij muaji, do të mbahen edhe zgjedhjet e rregullta në veri ashtu siç është

paraparë. “Besoj që pasi ka dakordim për planin, për aneksin për implementim, është në përfundim puna. Pra, pritjet që në ditët që vijnë shumë shpejt të arrihet dakordimi edhe për aneksin për implementim. Me rëndësi për Kosovën është që të fitohet në kohë për shkak se nëse marrëveshja arrihet gjatë këtij muaji, atëherë do të mund t’i mbajmë zgjedhjet e rregullta në veri ashtu siç është

paraparë”, është shprehur Haradinaj. Sipas Haradinajt, në marrëveshjen evropiane është edhe njohja nga Serbia. “Nuk qëndron konstatimi se ka njohjen, e ka njohjen marrëveshja, e ka njohjen në planin ndërkombëtar. Pra Serbia e njeh Pavarësinë e Kosovës, të drejtat si shtet i pavarur, i barabartë në bazë të kartës së OKB-së për planin ndërkombëtar”, ka thënë ai.



Kuvendi s’ka kuorum për votimin e tri marrëveshjeve ndërkombëtare

Prishtinë, 8 mars - Në mungesë të kuorumit, me një orë vonesë ka nisur të mërkurën vazhdimi i seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, në të cilën është paraparë të shqyrtohen 52 pika të mbetura pa përfunduar në nëntë seanca plenare të kaluara. Kuvendi ka nisur punimet vetëm pas heqjes nga rendi i ditës i votimit të tri marrëveshjeve ndërkombëtare.

Në sallë ka pasur kuorum për votimin e tyre, por në qëndrimet e mëhershme grupi parlamentar i LDK-së ishte deklaruar se nuk do të marrë pjesë në votimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar

për Zhvillim për “Projektin e reformës së sistemit të ndihmës sociale në Kosovë”, që ka qenë pika e parë në rendin e ditës. Vendimet për marrëveshje ndërkombëtare merren me dy të tretat e deputetëve. Shefja e deputetëve e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka propozuar një mocion për zhvendosjen e tri pikave të para të rendit të ditës, që

janë marrëveshje ndërkombëtare, në fund të rendit të ditës. Shefi i deputetëve i PDK-së, Abelard Tahiri, ka kërkuar që nga rendi i ditës të largohet vetëm pika e parë. “Pika e parë të spostohet. Për dy marrëveshjet e tjera kemi kuorum dhe mund t’i votojmë”, është shprehur Tahiri. Ndërsa shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka theksuar se


është e paqartë se çfarë po kërkon propozuesja e mocionit. “Ajo propozoi mocion derisa në sallë të bëhen 80 deputetë. Në sallë janë 82 deputetë”, është shprehur Gashi. Pas kësaj mocioni i LV-së është hedhur në votim dhe ka kaluar. Në këtë formë rendi i ditës është ndryshuar dhe Kuvendi ka vazhduar shqyrtimin e pikave të tjera.

AGK-ja: 65 për qind e gazetarëve në terren janë gra

PRISHTINË, 8 MARS - Në Kosovë, sipas gjetjeve të fundit të hulumtimit vjetor të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), 65 për qind e gazetarëve janë gra. Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas AGK-ja i ka falënderuar të gjitha koleget gazetare për punën e

palodhshme dhe guximin e treguar përgjatë vitit, duke raportuar nga terrene të ndryshme, shpesh duke e rrezikuar edhe veten. “Njëherësh, ju inkurajojmë të mos hiqni dorë nga ushtrimi i profesionit pavarësisht prej presionit që ndonjëherë e

krijon opinioni publik. AGK-ja, gjithashtu, u bënë thirrje organeve kompetente të sigurisë që t’i shtojnë përpjekjet për ta ofruar sigurinë e nevojshme që gazetarët ta kryejnë punën e tyre pa u rrezikuar”, është bërë me dije nga AGK-ja.



Vitia paralajmëron punësimin edhe të 42 inspektorëve shëndetësorë

Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Produktet Mjekësore i cili rregullon tregun e barnave në Kosovë, mbron qytetarët nga abuzimet me çmimet e barnave dhe avanco shërbimet shëndetësore në vendin tonë. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka thënë se kjo është një politikë e re për mbrojtjen e qytetarëve tanë, duke paralajmëruar punësimin edhe të 42 inspektorëve shëndetësorë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 MARS - Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Produktet Mjekësore, i cili rregullon tregun e barnave në Kosovë, mbron qytetarët nga abuzimet me çmimet e barnave dhe avanco shërbimet shëndetësore në vendin tonë. Ky projektligj ndërlidhet me prioritetin e qeverisë për sigurimin e barnave të nevojshme dhe me kosto të përballeshme për qytetarët dhe institucionet e Republikës.

Ky projektligj mori mbështetjen e plotë të kabinetit qeveritar. Gjatë prezantimit të tij, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka

thënë se kjo është një politikë e re në mbrojtjen e qytetarëve tanë. “Kjo nismë rregullon çmimet e produkteve mjekësore për qarkulluesit e licencuar farmaceutikë me shumicë dhe pakicë, përfaqësuesit e mbajtësve të autorizimit për marketing dhe institucionet publike. Projektligji ka për qëllim që kostoja e barnave në tregun farmaceutik të jetë e përballeshme e të jetë e krahasueshme me vendet e rajonit, madje edhe më lirë, dhe vendet e tjera referente dhe çmimi i një bari do të jetë njësoj në çdo barnatore”, ka thënë Vitia. Vitia shtoi se duke përcaktuar nivelizimin e çmimit të barnave dhe përcaktimin e çmimeve maksimale për blerje nga



institucionet publike krijohet për herë të parë sistemi rregullativ në Kosovë. “Miratimi i këtij projektligji konsiderohet me ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetësinë publike, duke ofruar qasje më të përballeshme të popullatës në barna të nevojshme. Ky sistem rregullativ është parakusht për themelimin e

sistemit të rimbursimit të barnave”, ka thënë ai.

Në një konferencë për medie Vitia ka thënë se është hera e parë që nga paslufta që në Kosovë po bëhet një rregullim i tillë. Ai ka bërë me dije se për ta mbikëqyrur zbatimin e këtij ligji MSh-ja do të punësojë edhe 42 inspektorë shëndetësorë të cilët janë

paraparë edhe në buxhetin për vitin 2023. “Një nga premtimet edhe në fushatë ka qenë trefishimi i numrit të inspektorëve në secilin sektor. Në buxhetin e këtij viti janë paraparë edhe 42 inspektorë shëndetësorë të cilët do të kontribuojnë në monitorimin e këtij ligji”, ka thënë Vitia.

Gratë protestojnë në Tiranë: Nuk duam lule, por drejtësi

TIRANË, 8 MARS - Mijëra këpucë të kuqe u vendosën në sheshin “Nënë Tereza” në Tiranë të mërkurën në shenjë proteste kundër dhunës ndaj grave në familje dhe shoqëri. Ky është 8 marsi i dytë që instalacioni “Këpucët e kuqe” zhvillohet në kryeqytetin e Shqipërisë në Ditën

Ndërkombëtare të Gruas. Kjo protestë e heshtur, e organizuar nga “Fem fest”, u shoqërua edhe me disa performanca me mesazhe kundër dhunës ndaj grave, mes tyre edhe një performancë e katër anëtarëve të grupit nga “Kosova Haveit”. Shoqata të shumta të grave në

Shqipëri organizuan edhe një marshim nga sheshi “Nënë Tereza” drejt ndërtesës së kryeministrit. Ato mbanin në duar pankarta të shumta me këto mesazhe: “Gratë nuk janë të sigurta në Shqipëri”, “Marshojmë, nuk festojmë, për një jetë pa dhunë ndaj vajzave dhe grave”, “Nuk është krim pasioni,

është femicid”.

Protesta në ditën e gruas vjen pak ditë pas një ngjarjeje të rëndë në Tiranë. Më 1 mars, Dan Hutra, 40 vjeç, vrau tri gra dhe plagosi dy të tjera, ndërsa më herët ishte dënuar për vrasjen e bashkëshortes së tij të parë. Një tjetër pankartë në protestë ishte

edhe “Drejtësi për Xhoin”, vajza nga Kenia e cila humbi jetën pasi u dhunua dhe u hodh nga ballkoni i banesës së saj në Tiranë. Ajo jetonte në Tiranë dhe punonte në një kazino. Familja e saj dhe disa prej grave që punonin me të, e kanë akuzuar një prej punonjësve të tjerë, por deri tani nuk ka asnjë të ndaluar.



Nostrifikimi i diplomave dhe siguria, probleme të shqiptarëve në Serbi dhe të serbëve në Kosovë

PRISHTINË, 8 MARS - Përkeqësimi i situatës së sigurisë në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, si dhe raportet e këqija të shqiptarëve të Luginës së Preshevës në jug të Serbisë me autoritetet qendrore, janë tema që qeveritë në Prishtinë dhe Beograd duhet t'i adresojnë. Kështu konstatoi Miodrag Milliqeviq, drejtor i organizatës joqeveritare "Aktiv" nga Mitrovica e Veriut, teksa paraqiti një hulumtim për pozitën e komunitetit serb në veri të Kosovës dhe të komunitetit shqiptar në jug të Serbisë.

Në këtë hulumtim, që u paraqit në Prishtinë, shqiptarë të Bujanocit, Medvegjës dhe Preshevës në jug të Serbisë dhe serbë të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut në veri të Kosovës, shprehën qëndrimet e tyre në lidhje me pjesëmarrjen dhe komunikimin e qytetarëve me pushtetin lokal dhe qendror, lirinë e lëvizjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, perspektivat e të rinjve dhe çështje të tjera.

Hulumtimi u krye në dhjetor të vitit të kaluar dhe janar të këtij viti me një mostër prej 350 të anketuarve në veri të Kosovës dhe 750 në jug të Serbisë.

Rezultatet nxorën në pah se besimi i komunitetit serb në Listën Serbe - partinë më të madhe të serbëve të Kosovës, e cila ka mbështetjen e Beogradit zyrtar -

ka rënë dukshëm. "Tendencat negative që janë shënuar në veri të Kosovës kanë ndikuar qartë në perceptimin e qytetarëve se ata janë të braktisur si nga institucionet qendrore, po ashtu edhe nga përfaqësuesit politikë lokalë, të cilët i konsiderojnë përgjegjës të drejtpërdrejtë për situatën aktuale në veri të Kosovës", tha Milliqeviq.

Gjatë vitit 2022 situata në veri të Kosovës është tensionuar disa herë dhe një nga arsytet për këtë ka qenë vendimi i Qeverisë së Kosovës për t'i reregjistruar makinat me targa ilegale serbe.

Pasojë e këtyre ngjarjeve ka qenë tërheqja e serbëve nga institucionet e Kosovës në veri. Sa i përket besimit në institucione, shumica e shqiptarëve të Luginës së Preshevës i beson më shumë Qeverisë së Kosovës - rreth 64 për qind e të anketuarve. Në anën tjetër, një në pesë të anketuar në mesin e komunitetit serb në veri të Kosovës i beson më shumë Qeverisë së Serbisë, ndërsa çdo i dyti i anketuar ka thënë se nuk ka besim tek askush.

Problem i përbashkët i serbëve nga veriu i Kosovës dhe i shqiptarëve nga jugu i Serbisë, sipas hulumtimit, është migrimi, gjegjësisht largimi i të rinjve, para së gjithash, për shkak të gjendjes së rëndë sociale dhe ekonomike. Përveç OJQ-së "Aktiv", në



hulumtim mori pjesë edhe Qendra për Demokraci dhe Edukim "Lugina" në Bujanoc. Agon Islami nga kjo qendër nxori në pah problemin e nostrifikimit të diplomave në Serbi, me të cilin, siç tha, përballen të rinjtë shqiptarë në Luginën e Preshevës. "Çdo i dyti i anketuar - ose rreth 51

për qind - beson se njohja reciproke e diplomave [ndërmjet Kosovës dhe Serbisë] do ta lehtësonte procesin e punësimit", tha Islami.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për njohjen reciproke të diplomave universitare në vitin 2011 në kuadër të dialogut për

normalizimin e marrëdhënieve, por në Serbi ajo është zbatuar vetëm deri në vitin 2014.

Njohja e ndërsjellë e diplomave përmendet edhe në planin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, të cilin dy vendet e kanë pranuar në parim.

Edhe në Kosovë festohet 8 marsi, liderët zotohen për barazi gjinore



PRISHTINË, 8 MARS - Përfaqësuesit e institucioneve të vendit kanë uruar për 8 Mars, Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se në Ditën Ndërkombëtare të Gruas le ta kujtojmë forcën, guximin dhe qëndrueshmërinë e jashtëzakonshme të grave dhe vajzave tona. Ajo ka thënë se në arsim, sport, kulturë, biznes, shkencë ose politikë, gratë kanë dëshmuar se janë të afta t'i arrijnë majat e suksesit. "Ato munden, sepse kanë potencial. Le të zotohemi të gjithë që ta bëjmë secili pjesën tonë të punës për t'u siguruar që zëri i çdo gruaje të dëgjohet, që potenciali i çdo gruaje të vijë në shprehje maksimalisht. Së bashku ne mund të krijojmë një botë ku gratë janë të barabarta e të lira për t'i përmbushur synimet e tyre. Të gjitha grave dhe vajzave të Republikës sot e çdo ditë: Mos ndaloni kurrë së ëndërruari, por në veçanti mos ndaloni kurrë së besuari", është shprehur Osmani në urimin e saj.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka uruar që barazia gjinore të arrihet sa më shpejt. "Të gjitha grave e vajzave po jua

urojmë 8 Marsin. Ky urim nuk është për gjendjen, por për përpjekjet e vazhdueshme për një barazi gjinore, që në të gjithë botën është larg të arrihet, si ideale, si barazi që e synojmë. Kërkojmë që secili prej nesh të punojmë që kjo të arrihet më shpejt", ka thënë Konjufca. Ai shpreson të mos jetë e vërtetë ajo që ka thënë sekretari i përgjithshëm i OKB-së që duhen treqind vjet të arrihet kjo barazi. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka theksuar se në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, të të gjitha grave, nderojnë sukseset që ato i kanë arritur historikisht. "Sot e çdo ditë nderojmë kontributin e grave, që nuk janë më dhe luftojmë bashkë me gratë dhe vajzat për më shumë të drejta e barazi. Qeverisja jonë mbetet e përkushtuar ndaj politikave demokratike dhe sociale, që e lehtësojnë barrën e padrejtësive, që gratë mbajnë mbi supet e tyre. Vazhdojmë përpjekjet dhe betejën për barazi shoqërore, për barazi gjinore. Prej shtëpisë e deri tek institucionet le ta bëjmë Kosovën më të barabartë. Gëzuar 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas!", ka thënë Kurti në urimin e tij.

Mbahet protesta “Marshojmë s’festojmë” me thirrjet për siguri ndaj grave

PRISHTINË, 8 MARS - Me thirrjet “Patriarkati vret” dhe “Vrasjet ndaj grave janë të paralajmëruara”, kolektivi “Marshojmë s’festojmë” ka protestuar të mërkurën në kërkim të respektimit të të drejtave të grave në Kosovë. Protesta ka nisur para Pallatit të Drejtësisë në Prishtinë dhe marshi ka vazhduar edhe në sheshin “Zahir Pajaziti”.

Protesta të ngjashme janë mbajtur edhe vitet e kaluara në Kosovë, në datën e njëjtë - 8 Mars - kur shënohet Dita Ndërkombëtare e Gruas.

Protestuesit janë dëgjuar edhe duke kërkuar dënime maksimale për vrasësit, dhunuesit dhe ngacmuesit e grave, dhe për më shumë siguri për gratë në ambientet publike dhe private.

Elvedina Hajdari, e cila ka thënë se ka qenë viktimë e dhunës në familje, ka thënë në protestë se është në kërkim të drejtësisë për gratë. Ajo ka thënë se institucionet e drejtësisë shpesh bëhen bashkëfajtores në dhunën që ushtrohet ndaj grave. “Si e mbijetuar e dhunës në familje, prej që e kam raportuar rastin më 2021, po bëhen dy vjet që unë luftoj për drejtësi dhe të drejtat e mia. Unë jam dëshmitare e neglizhencës, mosbesimit dhe padrejtësisë të vazhdueshme që u bëhen grave nga policia, prokuroria dhe



gjykata”.

Përfaqësues të Rrjetit të Grave të Kosovës u kanë thënë të mërkurën medieve se as këtë vit nuk do të festohet, pasi gjendja e grave në shoqëri vazhdon të mbetet shqetësuese, raporton REL.

Në Kosovë, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, çdo vit raportohen dhjetëra raste të dhunës seksuale.

Rrjeti i Grave të Kosovës ka thënë se numri më i madh i viktimave të kësaj dhune janë vajzat e moshës 13 deri në 16

vjeç.

Kodi Penal i Kosovës parasheh dënime nga dy deri në 15 vjet burgim për dhunime e sulmet e tjera seksuale.

Nga viti 2010 deri më 1 dhjetor 2022 në Kosovë janë vlarë 50 gra. Organizatat për mbrojtjen e

të drejtave të njeriut në disa raste kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

Arrestohet një serb i dyshuar për krime lufte kundër popullatës civile në Kamenicë



PRISHTINË, 8 MARS - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka njoftuar se në bashkëpunim me Njësinë për Hetime të Krimeve të Luftës në kuadër të Policisë së Kosovës ka arrestuar të pandehurin me inicialet Z. A., i nacionalitetit serb.

Prokuroria Speciale ka njoftuar se i pandehuri Z. A. dyshohet se gjatë periudhës së luftës në Kosovë, konkretisht në muajin mars 1999, në Stacionin Policor në Kamenicë, në cilësinë e personit zyrtar dhe në bashkëpunim me pjesëtarë të tjerë të policisë serbe, i uniformuar dhe armatosur, fillimisht kishte rrahur

të dëmtuarin me inicialet B. M. me shufra gome dhe shqelma, duke e torturuar në mënyrë çnjerëzore, maltretuar dhe duke i shkaktuar lëndime të rënda, trauma dhe pasoja në shëndet dhe duke e kanosur seriozisht për jetë për një orë e gjysmë, veprime këto të sanksionuara sipas ligjeve vendore, zakoneve të luftës dhe Konventave Ndërkombëtare të Gjenevës dhe protokolleve shtesë. “Po ashtu, ekziston dyshimi i arsyeshëm se i pandehuri Z. A. gjatë periudhës së luftës në Kosovë, konkretisht në periudhën shkurt-mars 1999, në

bashkëpunim me pjesëtarë të tjerë të policisë serbe dhe grupeve paramilitare, ka marrë pjesë në dëbimin dhe shpërnguljen me dhunë të qytetarëve të Kamenicës me rrethinë, pastaj ka filluar ta bëjë plaçkitjen e shtëpive e më pas, me qëllim të dëmtimit të pronës së shqiptarëve, ia ka vënë zjarrin, si dhe ka marrë pjesë në keqtrajtimin e civilëve shqiptarë. Me këto veprime i pandehuri Z. A. kishte për të kryer veprën penale ‘Krime lufte kundër popullatës civile’ nga neni 142 lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së”, ka njoftuar Prokuroria Speciale.

Qeveria nis shpronësimet për rrugën Kijevë - Zahaq

PRISHTINË, 8 MARS - Qeveria e Kosovës ka nisur lëvizjet e para për ndërtimin e rrugës Kijevë - Zahaq. Kështu u tha në mbledhjen e qeverisë të mbajtur të mërkurën, ku ekzekutivi ka miratuar propozimin e ndërtimit të rrugës përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore “Kooperativa Bujqësore

Podujevë” të cilat janë të nevojshme për realizimin e këtij projekti.

Zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, tha se janë përfunduar të gjitha procedurat për shpronësimin e pronave të paluajtshme për interes publik. “Departamenti i Shpronësimit në mënyrë

zyrtare ka pranuar nga zyra e pronës së paluajtshme aktin e vlerësimit të pronave të paluajtshme ish-shoqërore ‘Kooperativa Bujqësore Podujevë’. Pas plotësimit të kushteve të përcaktuara, ne propozojmë vendimin me të cilin miratohet vendimi përfundimtar i këtyre pronave të cilat janë të nevojshme”, tha ai.



Qeveria vazhdon t'i subvencionojë kursimtarët e energjisë



PRISHTINË, 8 MARS - Vendimi i Qeverisë së Kosovës për subvencionimin e faturave të konsumatorëve që kursejnë energji elektrike “do të vazhdojë të jetë në fuqi deri në një njoftim të ardhshëm”. Kështu iu përgjigjën zyrtarë të ekzekutivit pyetjes së “Radios Evropa e Lirë”, se deri kur do të subvencionohen këto fatura, marrë parasysh paralajmërimet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për mundësinë e ngritjes së tarifave të rrymës nisur nga data 1 prill.

Në bazë të vlerësimeve preliminare, tarifatat mund të rriten për 14 për qind, thanë nga ZRRE-ja, megjithëse vendimi është ende në fazën e konsultimeve.

Nga qeveria nuk deshën të flasin për ngritjen e mundshme të tarifave, duke thënë se “duhet pritur vendimi përfundimtar”.

Nga muaji shtator i vitit të kaluar Qeveria e Kosovës ka subvencionuar faturat e konsumatorëve, të cilët kanë kursyer së paku 5 për qind të energjisë së konsumuar në muaj krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Këta konsumatorë kanë përfituar dyfishin e përqindjes së kursyer.

Zyra e Rregullatorit për Energji i tha “Radios Evropa e Lirë” se lidhur me vlerësimet preliminare për rritjen e tarifave tashmë ka pranuar komentet nga Operatorit i Sistemit të Transmisionit të Tregut (KOSTT), Kompania për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS), Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), Korporata Energjetike e

Kosovës (KEK), Zyra e Presidentes dhe Zyra e Kryeministrit.

“ZRRE-ja është në proces të vlerësimit të komenteve të pranuar nga palët e interesuara dhe pas analizimit të tyre do të publikojë raportin përfundimtar me përgjigje ndaj palëve”, thuhet në deklaratën e ZRRE-së. Sipas saj, vendimi përfundimtar për ngritjen ose jo të faturave do të merret në mars.

Çfarë thonë qytetarët?

Disa qytetarë të anketuar nga “Radio Evropa e Lirë” në Prishtinë thonë se ngritja e tarifave të energjisë elektrike do të ndikojë negativisht në ekonominë e tyre familjare. Berat Simnica thotë se nëse ngritja arrin në 14 për qind, ajo do ta prekë “xhepin e varfër të qytetarëve”. “Edhe ashtu ka qenë e shtrenjtë [energji elektrike]. Por, tash, edhe ky 14-përqindësh, sado që duket i vogël, ndikon negativisht në buxhetin e familjes. E rëndon buxhetin e familjeve në Kosovë. Ne për çdo ditë po ballafaqohemi me kriza ekonomike. Jam i bindur se shtrenjtimi i rrymës ndikon edhe në çmimet e artikujve të tjerë ushqimorë dhe në koston e jetesës”, thotë Simnica.

Bukurije Gjonbalaj, e cila jeton vetëm me fëmijën e saj, thotë se shtrenjtimi eventual i rrymës do t’ia vështirësojë situatën ekonomike. “Në këtë situatë në të cilën është shoqëria jonë, ku nuk ka pasur rritje të pagave, nuk ka pasur zhvillime të tjera në kuptimin pozitiv për ekonominë tonë, rritja [e tarifave të energjisë elektrike] do të ishte shumë e madhe. Pra,

edhe për ekonominë e shtëpisë sime, ku jetoj vetëm me një fëmijë, është shumë e rëndë, me një pagë... Nuk po flas këtu për shpenzime të luksit, por për ato bazike”, thotë Gjonbalaj.

Imer Hakaj pret që ngritja eventuale e tarifave të energjisë elektrike t’i rrisë edhe çmimet e artikujve të tjerë të konsumit të përditshëm. “Qeveria e Kosovës dhe institucionet kompetente duhet ta kenë parasysh gjendjen e rëndë në Kosovë të cilën e kemi sot. Duhet të ndërhyjnë dhe të shohin ndonjë mundësi financimi ose diçka tjetër, sepse për familjet në Kosovë është bërë gjithçka e papërbalueshme për jetesë. Familjet në Kosovë nuk kanë qenë kurrë më të lodhura se tash”, thotë Hakaj.

Kosova e ka përmbyllur vitin 2022 me normë mesatare të inflacionit rreth 12 për qind dhe me pagë mesatare rreth 480 euro. Paga minimale sillet nga 130 deri në 170 euro, ndërsa pensionet nga 100 deri në 265 euro. Aktualisht konsumatorët që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë rrymë në orë brenda një muaji paguajnë 12.5 centë për kilovat gjatë tarifave të shtrenjta, ndërsa 5.9 centë gjatë tarifave të ulëta. Konsumatorët që shpenzojnë më pak paguajnë 7 centë për kilovat gjatë tarifave të shtrenjta dhe 3 centë gjatë tarifave të lira.

Tarifatat aktuale të energjisë elektrike do të jenë të vlefshme deri më 31 mars. ZRRE-ja bën shqyrtimin dhe caktimin e tarifave çdo vit.

KEDS-i hesht

Ngritjen e tarifave të energjisë elektrike e kërkoi Kompania për Distribuim të Energjisë

Elektrike (KEDS) dhe kërkesë e saj ishte që ngritja të jetë për 55 për qind. Kjo kompani nuk iu përgjigj pyetjes së REL-it se çfarë e ka shtyrë të kërkojë këtë rritje. Por, përmes një deklaratë më 8 shkurt, KEDS-i e ka justifikuar kërkesën për ngritje të tarifave të rrymës me ngritjen e çmimit të rrymës së importuar, si dhe me pamundësinë e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për të prodhuar rrymë të nevojshme, sidomos gjatë sezonit të dimrit.

“Mosreflektimi i duhur rrezikon pozitën financiare të KEDS-it, njëherësh rrezikon edhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend”, është thënë në këtë kërkesë. Aktualisht Kosova ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavate rrymë në orë, ndërsa nevojat e saj, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavate në orë. Kërkesën tjetër ajo e importon nga jashtë.

Kosova importon rrymën sipas çmimit të energjisë elektrike në bursën hungareze HUPX. Në gushtin e vitit 2021 çmimi ishte 150 euro për megavat. Në muajin gusht të vitit 2022 çmimi arriti në rreth 430 euro për megavat, por më vonë u stabilizua në rreth 260 euro. Më 7 mars të vitit 2023 çmimi për megavat në bursën HUPX ishte 142 euro.

Ramosaj: Ngritja nuk është e lartë, por efekti i madh

Duke u bazuar në lëvizjet globale të çmimeve, “ngritja e tarifave të energjisë elektrike për 14 për qind nuk është e lartë”, thotë Berim Ramosaj,

profesor i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës. Por, bazuar në strukturën e popullsisë në Kosovë dhe gjendjen e saj ekonomike, ngritja e tarifave të energjisë elektrike ngre pikëpyetje të mëdha për mundësinë e përbalimit, thotë Ramosaj. “Në qoftë se ka argumente të fuqishme ZRRE-ja se janë ngritur çmimet, atëherë qeveria do të duhej ta lejonte këtë ngritje të çmimeve. Por, gjithashtu, duhet t’i subvencionojë ato familje të cilat kanë të ardhura të ulëta, respektivisht ato shtesa të popullsisë të cilat vërtet nuk kanë pasur rritje të të ardhurave”, thotë Ramosaj për “Radion Evropa e Lirë”.

Ramosaj shton se nëse ngritja e tarifave të energjisë elektrike për 14 për qind do të jetë lineare, pra për të gjithë konsumatorët, atëherë për sipërmarrjet prodhuese, të cilat janë shpenzuese të mëdha të energjisë elektrike, do të ketë rritje të koston së prodhimit apo shërbimeve të tyre. Kjo, sipas tij, do të shkaktojë efekt zinxhiror dhe do të ketë rritje të çmimeve edhe për prodhimet e konsumit të përgjithshëm.

Pasojat, thotë Ramosaj, do t’i vuajnë më së shumti kategoritë sociale me të ardhura të ulëta. “Pavarësisht prej rritjes së çmimeve, në kushte normale qeveria do të ishte dashur t’i subvencionojë ato kategori”, thotë ai.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve i Kosovës, Hekuran Murati, ka thënë më 3 shkurt se nga subvencionet e qeverisë për rrymën kanë përfituar mbi 200 mijë familje.

Ish-anëtarja e Këshillit Drejtues e Bibliotekës Kombëtare: Gjendja në bibliotekë është e mjerë

Ish-anëtarja e Këshillit Drejtues e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", Ardiana Shala, e emëruar anëtare e këtij Këshilli nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, në muajin maj të vitit 2022, më 28 shkurt 2023 ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga Këshilli Drejtues i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, me arsyetimin se "nuk mujta me i kapërcy dallimet e mëdhaja kulturore e intelektuale e ideologjike mes meje dhe disave prej anëtarëve të këtij këshilli drejtues, saktësisht anëtarëve 'veteranë' të këshillit drejtues, që po get ishin mësu jo veç me kenë aty, por me kenë aty në udhëheqësi, direkt ose mbrapa shpine, pa asnjë vizion për zhvillimin e bibliotekës e me shumë energji me pengu çdo frymë të re ndryshimi (edhe me qëllim, e edhe pa qëllim thjeshtë prej injorancës)".

Shala në llogarinë personale në "Facebook" ka dhënë arsyetimin pse ka dhënë dorëheqje nga të qenit anëtare e Këshillit Drejtues. Sipas saj, "gjendja në bibliotekën kombëtare të Kosovës asht e mjerë".

Gazeta "Epoka e re" muaj më parë ka raportuar për disa parregullsi në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe për pakënaqësitë e punëtorëve të saj. Po ashtu, redaksia e gazetës "Epoka e re", pas dorëheqjes së Ardiana Shalës nga Këshilli Drejtues, ka kontaktuar edhe me kryetarin e Shoqatës Sindikale të Punonjësve të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Ramush Zeka, për të marrë një mendim të tij lidhur me pakënaqësitë që ka shprehur publikisht ish-anëtarja e Këshillit Drejtues, Ardiana Shala. Zeka ka thënë se nuk ka çfarë t'i heqë asgjë reagimit të saj, përpos që t'i shtojë. "Të gjitha ato pakënaqësi që ka shprehur zonjusha Shala në letrën e dorëheqjes janë me vend dhe të sakta. Nuk kam çfarë t'i heq asgjë opinionit të saj, përpos të shtoj. Për këtë gjendje të Bibliotekës Kombëtare, përpos që me shkresa e kemi informuar muaj më parë Këshillin Drejtues të Bibliotekës Kombëtare, e kemi informuar edhe ministrin e Kulturës, z. Hajrulla Çeku, por asnjë veprim, në të mirë të gjendjes së bibliotekës, nuk është marrë as nga ministri Çeku, as nga Këshilli Drejtues. Padyshim që në komunikimet që kemi pasur me anëtarët e Këshillit Drejtues, më e zëshmjja, më e përgjegjshmja, më bashkëpunëtorja me ne ka qenë Ardiana Shala. Po të ishte ajo ende anëtare, mbase do të përmirësohej gjendja në bibliotekë, sepse e ka kuptuar më mirë se cilido tjetër rolin dhe funksionin e Bibliotekës Kombëtare. Tash që ajo ka dhënë dorëheqje dhe ka numëruar dhjetëra të meta në bibliotekë, po presim të reflektojë ministri Çeku. Pakënaqësinë e saj, as tonën s'i sindikatë, nuk duhet ta heshtë ministria, ministri Çeku. Nëse ata heshtin, mediet duhet të shkruajnë e të flasin vazhdimisht për



gjendjen e rëndë të Bibliotekës Kombëtare. Ju lutem, lexojeni reagimin e plotë të zonjushës Shala po qe se dëshironi të dini për gjendjen e bibliotekës. Asaj aferim i qoftë për guximin që ka shprehur që, çështjet që ka ngritur në Këshill, me ministrin e Kulturës dhe me punonjës të Bibliotekës Kombëtare, i ka shprehur edhe publikisht për opinionin e gjerë. Meqë zonjushën Shala ministri Çeku e ka zgjedhur për anëtare të Këshillit Drejtues, tash duhet të lëvizë ministri. Askush më mirë sesa ajo nuk i ka raportuar ministrit Çeku. Askush më saktë se ajo nuk e ka thënë të vërtetën për Bibliotekën Kombëtare", ka thënë Ramush Zeka.

Se si është gjendja sot në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, më poshtë mund ta lexoni reagimin e plotë të Ardiana Shalës, publikuar pa asnjë ndërhyrje nga gazeta "Epoka e re".

NJOFTIM PUBLIK (i shkurtë, besomni)

Në fund të majit në 2022 jam emnu anëtare e këshillit drejtues të bibliotekës kombëtare të Kosovës.

Nji detyrë që e pata pranë me idenë që e kam nji fare obligimi moral edhe që kam mjaft dije e përvojë, dhe vullnet, (edhe pse më mungojke koha, e gjetta dhe e bana) me ndihmu në ndërtimin e zhvillimin, për mos me thanë në ringjalljen e bibliotekës kombëtare të Kosovës.

Me 28 shkurt 2023, mas shumë netëve pa gjum e ndërgjegjjes së vrame që u pagujsha prej pareve të ktij populli për me shku aty e mos me u leju (bile bile edhe me u pengu) me nisë me mendu për qysh-asht e mundshëm, se le ma me ba ndryshime thelbësore, masi që e tejkalova iluzionin që ja vlenë me provu, e me e provu, hajt edhe naj ditë, hajt edhe naj ditë, dhash dorëheqje (me 9 faqe arsyetime adresu tek ministri

Çeku) nga kjo detyrë.

Arsyet për dorëheqjen teme nga këshilli drejtues i bibliotekës kombëtare të Kosovës janë të shumta por munden me u përmbledhë në nji të përbashkët të madhe që ka të baj me natyrën ideologjike e kulturore të punës, të komunikimit e të të menduemit kritik. Nuk mujta me i kapërcy dallimet e mëdhaja kulturore e intelektuale e ideologjike mes meje dhe disave prej anëtarëve të këtij këshilli drejtues, saktësisht anëtarëve 'veteranë' të këshillit drejtues, që po get ishin mësu jo veç me kenë aty, por me kenë aty në udhëheqësi, direkt ose mbrapa shpine, pa asnjë vizion për zhvillimin e bibliotekës e me shumë energji me pengu çdo frymë të re ndryshimi (edhe me qëllim, e edhe pa qëllim thjeshtë prej injorancës). Për ma zi, i kishin krahët e fortë. Aty ku un dështova me ndryshu najsen pse s'mujta, ministri, sipas meje, dështoi me e dashtë përnime ndryshimin që më pat thanë se e don.

Kur po e mendoj tash, veç me e pasë pa ju qysh u zgjodh kryesuesi; se qysh e pse s'kam dhanë dorëheqje menjherë atë ditë (po get isha e dehun tu andrru), duheni me më falë, sepse fundit i fundit më keni dhanë nji fare pagese muej më muej plus/minus 400 euro gjithë kta muej, për të cilat s'kam kurrë me ju raportu që me thanë; por nejtë nuk asht që kam marrë rrogë 5560 euro në muej si naj konsultante e naltë a najsen; po du me thonë që hajt mos u kani fort se ka edhe ma keq. Me e thanë pak ma shkurt: kam dhanë dorëheqje, në thelb, ma së pari për arsye parimore. Dhe këtu që ku e keni nji ngushëllim të vogël, që nashta kjo në vete asht nji fare ndryshimi?! Dorëheqje për me mbrojtë parime. Sepse, un besoj që pa mbjell parime ndryshe e të hajrit s'mundet me pasë korje të ndryshimeve pozitive në kit vend.

Besoj, në fakt e di që ky këshill drejtues me anëtarë të vjetër në te

nuk mundet me pru ndryshime e zhvillime të reja, shumë të nevojshme në bibliotekën kombëtare të Kosovës, sepse praktikat e kqija janë ba ligje aty, se kultura kritike, e as vizioni politik për ndryshime të nevojshme s'ekziston për bibliotekën kombëtare të Kosovës. Mundem me e thanë që gjendja në bibliotekën kombëtare të Kosovës asht e mjerë. Aq e mjerë sa e dhimbshme deri në palcë. Ajo bibliotekë ma së pakti asht bibliotekë. Momentalisht funksionin kryesor e ka në ofrimin e hapësirës për ahengje të ndryshme kulturore (veç edhe dasmet kanë mbetë me u organizu aty). Apo ndoshta edhe ajo ka ndodh. Nuk e di, pse a kah me e ditë?

Ndër disa raste të ndryshme, secila me njollat e vetta, hipokrizia kulmnore po get që ishte dekorimi i bibliotekës kombëtare me medalje presidenciale për merita mu qaty përskej dekorimit për familjen Jashari (s'kam fjalë me e përshkru çfarë nënçmimi nënkupton kjo për familjen Jashari), e që u pranë nga këshilli drejtues, e pa e informu këshillin drejtues (se thjeshtë bre ka shku kryesuesi pa kallxu e pa e pvetë kend, e kryesuesi mendon që s'i ka borgj kurrë s'qarime, po get). Pra biblioteka (qekjo e mjera me dy guj për toke) dekorohet ba ti be thu se e meriton. Ama nuk e meriton as afër. Kjo asht nji prej atyne rasteve palidhje, por jo edhe aq kur e vnon në kontekst të gjendjes së bibliotekës, që sikur të kisha qenë un në këshill drejtues të bibliotekës kombëtare të Kosovës nuk e kisha leju me ndodhë kurrë kit dekorim. Presidenca medalje le të shkepë sa të doj, s'mujë me e ndalë, ama, biblioteka me pranë s'kish guxu kurrë. Uh, pardon, prit, prit, se un pasna kenë more në këshill kur ka ndodhë kjo hipokrizi kolosale, por a më besoni që s'di sen (edhe plot sene tjera kishte tendenca të vazhdueshme me më pengu me i ditë; e plot të tjera nuk i di se as bib-

lioteka vet s'i din, qekaq di).

Përkundër dëshirës së madhe, un s'isha aty për me ditë najçka, çka bahet, kur bahet, pse bahet, ku bahet, qysh bahet, e qysh s'bahet?! E marrim vesh nëpër media barabartë me juve masi që të bahet, sa i përket atyne të bamave për konsum medial. Të tjerat mbesin në hije, nën pluhurin e trashë. Pse, çka menduet ju, me u lodhë kryesuesi i këshillit drejtues të bibliotekës kombëtare të Kosovës, para se me pranë nji dekorim të tillë për bibliotekën në emën të këshillit drejtues, me i informue anëtarët e këshillit që po dojka dikush me e dekoru nji institucion që gjindet në buzë të greminës për shkak të keqmenaxhimit, neglizhimit politik dhe ndërhyrjeve partiake (për me e thanë ma të paktën) tash e dy dekada, a? Po a? E me e hup tani shansin me e ba nji foto me presidentën e me i dalë emni në faqe të bibliotekës si "akad" a? Nejtë, po i bi shkurt. Bibliotekë e dashtun kombëtare e Kosovës qe nji këshill të fundit kështu si lamtumirë nga pragu: "akad" nuk asht titull. Pra me konë anëtarë i nji akademie NUK asht titull. Nuk vnohet para emnit "akad." o njerëz të kompleksuem e të palexuem deri në asht që i ngreni zhag kto komplekse kah të shkoni dhe e merrni në qafë nji popull të tanë tue u ngjitë për karriga.

Pra, sa i përket bibliotekës kombëtare, çfarë jena qasi e kena. E pra, çfarë jena? Asht koha me e përgjegj secili për vete kit pyetje e me këqyr mos pahiri e meritojna ma të mirë?!

E sa më përket mu, kur të vjen dita që përnime ka vend e bahet vend për ndryshime në kit vend, knej pari jam, tu andrru. Vj pa hatër. Por s'vi veç sa për me ardhë. Kështu që, ju lutem, mendohuni mirë e mirë a me më thirrë. Që mos t'i humbim kohë kot njanji tjetrit.

Sinqerisht,
Ardiana SHALA

Ti dhe bomba atomike



George ORWELL

Duke marrë parasysh sa ka gjasa që ne të gjithë të bëhemi copë e çikë prej saj brenda pesë vjetëve të ardhshme, bomba atomike nuk ka ngjallur aq shumë diskutime sa mund të pritej. Gazetat kanë botuar diagrame të shumta, jo shumë të dobishme për njeriun mesatar, të protoneve dhe neutroneve prej të cilave përbëhen, dhe ka pasur shumë përsëritje të deklaratës së padobishme se bomba “duhet të vihet nën kontrollin ndërkombëtar”. Por çuditërisht pak është thënë, gjithsesi në shtyp, për pyetjen që është me interes më urgjent për të gjithë ne, pikërisht: “Sa të vështira janë këto gjëra për t’u prodhuar?”

Informacione të tilla që ne – domethënë publiku i gjerë – zotërojmë për këtë temë, na kanë ardhur në një mënyrë mjaft të tërthortë, në kundërshtim me vendimin e presidentit Truman për të mos ia dorëzuar disa sekrete BRSS-së. Disa muaj më parë, kur bomba ishte ende vetëm një thashetheme, besohej shumë se ndarja e atomit ishte thjesht një problem për fizikanët dhe se kur ata ta kishin zgjidhur, një armë e re dhe shkatërruese do të ishte në dispozicion të pothuajse të gjithëve. (Në çdo çast, kështu vijuan thashethemet, një i çmendur i vetmuar në një laborator mund ta bëjë qytetërimin pluhur e hi, aq lehtë sa ndezja e një fishekzjarri.)

Nëse kjo do të ishte e vërtetë, i gjithë drejtimi i historisë do të ishte ndryshuar papritmas.

Dallimi midis shteteve të mëdha dhe shteteve të vogla do të ishte fshirë dhe fuqia e shtetit mbi individin do të ishte dobësuar shumë. Megjithatë, nga fjalimet e presidentit Truman dhe komentet e ndryshme që janë bërë për to, duket se bomba është jashtëzakonisht e shtrenjtë dhe se prodhimi i saj kërkon një përpjekje të madhe

industriale, siç janë në gjendje të bëjnë vetëm tre ose katër vende në botë. Kjo pikë është e një rëndësie thelbësore, sepse mund të nënkuptojë se zbulimi i bombës atomike, aq larg nga ndryshimi i historisë, thjesht do të forcojë prirjet që kanë qenë të dukshme gjatë një duzine vitesh më parë.

Është e gjë e zakonshme të thuhet që historia e qytetërimit është kryesisht histori e armëve. Në mënyrë të veçantë është vënë në dukje vazhdimisht lidhja midis zbulimit të barutit dhe përmbyesjes së feudalizmit nga borgjezia. Dhe megjithëse s’kam dyshim se mund të bëhen përjashtime, mendoj se rregulli i mëposhtëm do të ishte përgjithësisht i vërtetë: se epokat në të cilat arma mbizotërore është e shtrenjtë ose e vështirë për t’u prodhuar do të priren të jenë epokat e despotizmit, ndërsa kur arma dominuese të jetë e lirë dhe e thjeshtë, njerëzit e thjeshtë e kanë një shans. Kështu, për shembull, tanket, luftanijet dhe aeroplanët bombardues janë në thelb armë tiranike, ndërsa pushkët, mushqetat, harqet e gjata dhe granatat e dorës janë në thelb armë demokratike. Një armë e ndërlikuar e bën të fortin më të fortë, ndërsa një armë e thjeshtë – përderisa nuk ka një më të mirë – i jep kthetrat të dobët. Epoka e madhe e demokracisë dhe e vetëvendosjes kombëtare ishte epoka e mushqetës dhe e pushkës. Pas shpikjes së strallit dhe para shpikjes së kapsollës, mushqeta ishte një armë mjaft e efektshme dhe në të njëjtën kohë aq e thjeshtë sa mund të prodhohej thuajse kudo. Kombinitimi i cilësive të saj bëri të mundur suksesin e revolucioneve amerikane dhe franceze dhe e bëri një kryengritje popullore një çështje më serioze sesa mund të ishte në kohën tonë. Pas mushketës erdhi pushka me fole fisheku. Ajo ishte një gjë deri diku e ndërlikuar, por ende mund të prodhohej në shumë vende, dhe ishte e lirë, kalo-

hej lehtësisht kontrabandë dhe harxhonte pak municion. Edhe kombi më i prapambetur mund të rrokte pushkët nga një burim ose një tjetër, në mënyrë që boerët, bullgarët, abisininët, marokenët – madje edhe tibetanët – të mund të luftonin për pavarësinë e tyre, nganjëherë me sukses.

Por më pas çdo zhvillim në teknikën ushtarake ka favorizuar shtetin kundër individit dhe vendin e industrializuar kundër atij të prapambetur. Ka gjithnjë e më pak vatra pushteti. Në vitin 1939 kishte vetëm pesë shtete të afta për të bërë luftë në shkallë të gjerë, dhe tani janë vetëm tri – në fund të fundit, ndoshta, vetëm dy. Kjo prirje ka qenë e dukshme prej vitesh dhe është vënë në dukje nga disa vëzhgues edhe para vitit 1914. E vetmja gjë që mund ta përmbysë këtë realitet është zbulimi i një arme – ose, për ta thënë më thjesht, i një metode luftimi – që nuk varet nga përqendrimi të mëdha të fabrikave industriale.

Nga shenja të ndryshme mund të arrihet në përfundimin se rusët nuk e zotërojnë ende sekretin e prodhimit të bombës atomike; nga ana tjetër, ka një pajtim të përgjithshëm të opinionit publik se do ta zotërojnë brenda pak vitesh. Pra, kemi para nesh perspektivën e dy ose tre super-shteteve përbindësh, secili i zotëruar me nga një armë me të cilën miliona njerëz mund të zhduken brenda pak sekondash, duke e ndarë botën mes tyre. Është nxituar të hamendësohet se kjo nënkupton luftëra më të mëdha dhe më të përgjakshme dhe, ndoshta, një fund të qytetërimit të makinerive. Por supozoni – dhe me të vërtetë ky zhvillim më i mundshmi – që kombet e mëdha të mbijetuar bëjnë një marrëveshje të heshur për të mos përdorur kurrë bombën atomike kundër njëri-tjetrit? Supozoni se e përdorin, ose kërcënin për ta përdorur, vetëm kundër njerëzve që nuk janë në gjendje të hakmerren? Në atë rast

ne jemi kthyer aty ku ishim më parë, i vetmi ndryshim është se pushteti është i përqendruar në duar akoma më të pakta dhe se perspektiva për popujt e nënshtruar dhe klasat e shtypura është akoma më e pashpresë.

Kur Xhejms Bërnëm shkroi Revolucionin menaxhues, shumë amerikanëve iu duk e mundshme që gjermanët do ta fitonin fundin evropian të luftës, dhe për këtë arsye ishte e natyrshme të supozohet se Gjermania dhe jo Rusia do të dominonin masën e tokës euroaziatike, ndërsa Japonia do të mbetej zotëruese e Azisë Lindore. Ishte llogaritje e gabuar, por nuk ndikon në argumentin kryesor. Sepse fotografia gjeografike e Bërnëmit për botën e re ka rezultuar e saktë. Gjithnjë e më qartë sipërfaqja e tokës po ndahet në tri perandori të mëdha, secila e pavarur dhe e shkëputur nga kontakti me botën e jashtme, dhe secila e sunduar, nën një maskim apo një tjetër, nga një oligarki e vetëzgjedhur. Pazarit se ku do të përcaktohen kufijtë vazhdon ende dhe do të vazhdojë për disa vjet, dhe i tretë nga tre super-shtetet – Azia Lindore, e dominuar nga Kina – është ende potencial më shumë sesa realitet. Por lëvizja e përgjithshme është e pagabueshme dhe çdo zbulim shkencor i viteve të fundit e ka përshpejtuar.

Një herë na thanë se aeroplani kishte “hequr kufijtë”; në fakt, vetëm pasi avioni u bë armë serioze, kufijtë janë bërë përfundimisht të pakalueshëm. Dikur pritej që radioja ta promovonte mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar; ka rezultuar të jetë një mjet për të izoluar një komb nga një tjetër. Bomba atomike mund ta përfundojë procesin duke grabitur klasat e shfrytëzuara dhe popujt e të gjitha fuqive për t’u revoltuar dhe, në të njëjtën kohë, t’i vërë zotëruesit e bombës mbi bazën e barazisë ushtarake. Në pamundësi për ta pushtuar njëri-tjetrin, ka të ngjarë të

vazhdojnë ta sundojnë botën mes tyre dhe është e vështirë të shihet se si mund të prishet ekuilibri përveç ndryshimeve të ngadalta dhe të paparashikueshme demografike.

Para dyzet a pesëdhjetë vjetësh, H. G. Uells dhe të tjerë na paralajmëruan se njeriu rrezikon ta shkatërrojë veten me armët e tij, duke lënë pas milingonat ose disa lloje të tjera që të mbijetojnë e të na zënë vendin. Kushdo që ka parë qytetet e rrënuara të Gjermanisë do ta çoj ndër mend edhe këtë nocion. Megjithatë, duke parë botën në tërësi, zhvendosja për shumë dekada nuk ka qenë drejt anarkisë, por drejt rivendosjes së skllavërisë. Mund të shkojmë jo drejt shkatërrimit të përgjithshëm, por drejt një epoke kaq tmerrësisht të qëndrueshme sa perandoritë e skllavërive të antikitetit. Teoria e Xhejms Bërnëmit është diskutuar shumë, por pak njerëz i kanë marrë parasysh nënkuptimet e saj ideologjike – domethënë llojin e botëkuptimit, llojin e besimeve dhe strukturën shoqërore që, ndoshta, do të mbizotëronin në një shtet që ishte njëkohësisht i pamposhtur dhe në një gjendje të përhershme “lufte të ftohtë” me fqinjët.

Nëse bomba atomike do të ishte diçka aq e lirë dhe që prodhohet lehtësisht si një biçikletë apo një orë me zile, mund të na kishte zhytur përsëri në barbarizëm por, nga ana tjetër, mund të kishte nënkuptuar fundin e sovranitetit kombëtar dhe të shtetit policor shumë të centralizuar. Nëse, siç duket, është një objekt i rrallë dhe i kushtueshëm aq i vështirë për t’u prodhuar sa një luftanije, ka më shumë gjasa t’u jepet fund luftërave në shkallë të gjerë me koston e zgjatjes së pafundme të një “pajeje që nuk është paqe”.

Tribune, 19 tetor 1945

Përktheu nga anglishtja: Granit Zela. Të drejtat e botimit, “Armagedoni”.

Reichstag, e vërteta e fshehur e zjarrit që Hitleri e përdori për eliminimin ekundërshtarëve



Nga Paolo VALENTINO

Kur në një mëngjes të ftohtë janari të vitit 1934, Martin van der Lubbe pa trekëmbëshin ngritur në oborrin e gjykatës së Leipzig, u tërbua nga zemërimi. U përpoq të çlirohej nga gardianët, nisi të fyente gjyqtarët dhe anëtarët e qeverisë që kishin ardhur për të parë ekzekutimin e tij dhe lëshoi një klithmë të dëshpëruar: "Po të tjerët ku janë?"

Por kujt i referohej ai? Kishin kaluar 317 ditë që nga 27 shkurti i vitit 1933, kur radikali i majtë holandez, vetëm 24 vjeç, u arrestua në vendin e krimit dhe rrëfeu menjëherë. Ishte ai gjysmë ore më herët, që kishte ndezur zjarrin në Reichstag, selinë e parlamentit gjerman.

Ai rezultoi të ishte "zjarri i shekullit". Adolf Hitleri ishte bërë kancelar më 30 janar, i emëruar nga presidenti Paul von Hindenburg në përputhje të plotë me Kushtetutën e Vajmarit. Liritë civile ekzistonin ende në letër, edhe pse tashmë kishin nisur të ndodhnin gjëra shqetësuese, si mbyllja e gazetave të majta, spastrimi nga administrata publikë i zyrtarëve "të pabesueshëm" apo ligjërimi i dhunës nga milicite naziste SA, SS dhe Stahlhelm.

Republika e brishtë e lindur nga disfata e Luftës së Parë Botërore mbeti në këmbë për njëdekadë e ca. Por në ato momente fatale, Reichstagsbrand (zjarri i Reichstagut) e ndryshoi rrjedhën e historisë. Teksa flakët nuk ishin shuar ende, nisi ajo që Sebastian Haffner do ta kishte quajtur "terrori ligjor i shtetit".

"Nuk do të ketë asnjë mëshirë. Kushdo që synon të na pengojë do të rrëzohet! Çdo funksionar komunist duhet të pushkatohet në vend. Deputetët komunistë duhet të varen që këtë natë!" - do të shprehej Hitleri. Dhe në fakt ashtu ndodhi. Mijëra politikanë dhe militantë të opozitës jo vetëm komuniste, intelektualë dhe gazetarë, u arrestuan po atë natë teksa ishin duke fjetur dhe u mbyllën në kampe përqendrimi të improvizuara, u torturuan, apo thjesht u vranë.

Listat ishin përgatitur prej disa kohësh nga Ministri i Brendshëm i Prusisë, Hermann Göring. Të nesërmen, në muret e Berlinit u shfaq e famshmjia "Urdhëresë mbi zjarrin e Reichstag", e cila pezulloi me të një rënë të lapsit të gjitha liritë themelore të njeriut, forcoi masat penale, dhe e zhdukua federalizmin. Ajo do të mbetej në fuqi deri në rënien e diktaturës së Hitlerit.

Në fakt, flakët e zjarrit të vënë nga Van der Lubbe i ofruan Hitlerit dhe klikës së tij kriminale mundësinë për të zhdukur brenda pak orësh atë që kishte mbetur nga Republika e Vajmarit. Nëntëdhjetë vjet më vonë, mbizotëron ende teza se i riu holandez, që ndër të tjera vuante nganjë formë e rëndë miopisë, i bëri të gjitha vetë, duke arritur të hynte dhe të rrafshonte brenda pak minutash një ndërtesë të madhe siç ishte Reichstag-u. Me kalimin e kohës, ky variant u përforcua nga një investigim i famshëm i "Der Spiegel" i botuar në fund të viteve 1960 dhe nga mendimi i historianëve të

famshëm, nga Hans Mommsen tek Ian Kershaw.

Në fakt dilema nëse ekstremist holandez kishte vepruar në mënyrë të pavarur apo kishte pasur bashkëpunëtorë, nuk ka zgjedhur kurrë zgjidhje. Teza të ndryshme e kanë kundërshtuar variantin zyrtar. Nga ai i dashur për nazistët i një komploti komunist, i mohuar edhe nga gjykata që i liroi të akuzuarit e tjerë, përfshirë kryeministrin e ardhshëm bullgar Georgi Dimitrov, deri tek ai i një Van der Lubbe të "manipuluar" nga vetë nazistët, që supozohet se e kanë ndihmuar fshehurazi në zjarrvënie.

Debatu në fjalë është rindezur sërish kohët e fundit, për shkak të librit të studiuesit gjerman Uwe Soukup, që është marrë prej vitesh me këtë çështje. Në librin me titull "Die Brandstiftung. Mythos Reichstagsbrand - Was in der Nacht geschah, in der die Demokratie unterging" (Zjarrvënia. Miti i zjarrit të Reichstagut. Çfarë ndodhi natën kur u shemb demokracia), botuar nga shtëpia botuese "Heyne", Soukup e pranon se nuk mund të provojë dot një tezë alternative.

Gjithsesi ai nën bashkë një seri mbresëlënëse të dhënash, të cilat nga njëra anë demaskojnë kontradiktat dhe dobësitë strukturore të skenarit një të faktori të vetëm, dhe nga ana tjetër e drejton gishtin tek përfshirja së nazistëve, ose më saktë e një pjesë të tyre në përgatitjen dhe zbatimin e aktit.

Një nga këto vjen nga Hermann Göring, që në një bisedë me prokurorin e Gjykatës së

Nurembergut, Robert Kempner, në vitin 1946 deklaroi se ndoshta SA e Berlinit, e drejtuar nga Karl Ernst, qëndronte pas atij zjarri. Pra pikërisht milicia rebele që kundërshtoi "kursin e ligjshmërisë" së Hitlerit, dhe që në vitin e 1934 e pagoi mospajtimin me masakrimin eudhëheqësve të saj.

Teza e Göring mbështetet edhe nga zbulimi i fundit i deklaratës së Hans Martin Lennings, një nazist që në vitin 1955 i tha një noteri në Hanover, se kishte marrë nga SA urdhrin për të çuar Van der Lubben në Reichstag mbrëmjen e 27 shkurtit 1933.

Një lidhje tjetër me SA është ajo e Hans-George Gewehr, një ekspert i njohur i lëngjeve të ndezshme, i konsideruar si kreu i brigadës së zjarrfikësve të milicisë naziste. I njohur me nofken Pistolen-Heini, sipas disa dëshmitarëve ai u ishte mburrur në gjendje të dehur se kishte marrë pjesë në Reichstagsbrand.

Akoma më e rëndësishme është dëshmia e dhënë për Soukup nga Ruth Weiss, një shkrimtare 98-vjeçare, e veja e Hans Weiss, një gazetar "Berliner Tageblatt" shumë më i madh në moshë se ajo. Ai i kishte treguar asaj se mbrëmjen e 27 shkurtit kishte shkuar në Reichstag së bashku me një koleg, që shkonte rregullisht në parlament që dhe e njihnte mirë ndërtesën.


Ata ishin në një hyrje anësore, kur panë një grup të rinjsh të veshur me pallto duke dalë fshehurazi nga një portë e madhe. Ata hipën në një kamion që i priste aty pranë

dhe u larguan me shpejtësi. Kur hynë në ndërtesë, Weiss dhe kolegu i tij ndjenë një erë të fortë benzine.

Në libër rrëfohen detaje të tjera, si tabelat prej druri dhe kartoni me emrat e deputetëve të Reichstagut, mbi 1 copë që normalisht mbaheshin në një baule prapa foltores. Ato u gjetën të bëra shkumb e hi në mes të sallës. Po kush i kishte lëvizur? Sigurisht jo Van der Lubbe, që nuk mund ta dinte se ku ishin dhe që veprimi në një kohë shumë të shkurtër.

Po si arriti holandezi të ngitej në një parvaz 8 metra lart për të hyrë në godinë, siç deklaroi në gjyq? Dhe pse nuk u mor parasysh një dëshmitar që tha se kishte parë dy persona që thyenin disa xhama me trashësi mbi 8 milimetra? Së fundi, Soukup risjell në kujtesë qëndrimin apatik të Van der Lubbe në gjyq, që nxit dyshimet se ai ishte drogatar.

Një dyshim që ka çuar tashmë në një përfundim të bujshëm: në fund të janarit të këtij viti u hap varri i Van der Lubbe në varrezat e Leipzig-it, dhe eshtrat e tij janë dërguar për ekzaminim nga një ekip i mjekësisë ligjore. "Megjithatë, as këto hetime nuk do të zgjidhin misterin e asaj që ndodhi më 27 shkurt 1933 në Reichstag" - pranon Soukup, që shton se gjithsesi "rifillimi i debateve mbi atë ngjarje është i pashmangshëm". Dhe përfundon duke thënë: "Rrethanat e sakta të vdekjes së demokracisë së parë gjermane nuk mund të na lënë të qetë as 90 vjet më vonë." / "Corriere della Sera" - Bota.al



Veton Zymberi, redaktor i sportit

'Marca': Mallorca është e varur nga Muriqi

MALLORCA, 8 MARS - Skuadra e Mallorcas është totalisht e varur nga sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi. Kështu shkruhet në artikullin e gazetës spanjolle "Marca". Mund të thuhet se sa herë nuk

ka luajtur sulmuesi kosovar, skuadra e Javier Aguirre ka humbur. Kjo të paktën ka ndodhur tri herë gjatë këtij edicioni. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe këtë të diel, kur ekipi i futbollistit nga Prizreni

do të luajë të dielën me Real Sociedadin, pasi që Muriqi është ndëshkuar me kartonin e verdhë në ndeshjen kundër Elches, të pestin, që ia pamundëson paraqitjen gjatë kësaj ndeshje. 28-vjeçari ka

shënuar 10 gola deri më tani në La Liga, duke qenë futbollisti kryesor i skuadrës. Aguirre tani thuhet se është plotësisht i varur nga shërbimi i "Piratit", pasi nuk ka zëvendësues adekuat.



Çeku: FFK-ja ende ka punë për licencim, s'ka rrezik të përjashtohemi nga FIFA e UEFA

"Epoka e re"

PRISHTINË, 8 MARS - Ministri i Sportit, Hajrulla Çeku, ka thënë se Federata e Futbollit e Kosovës nuk është ende e gatshme për t'u licencuar në MKRS. Sipas Çekut, FFK-së i nevojitet ende punë për t'i plotësuar kriteret e licencimit, ndërsa bëri me dije se nuk ka rrezik për përjashtimin e FFK-së nga FIFA e UEFA për shkak të moslicencimit. "Nuk ka kurrfarë rreziku të përjashtimit të Federatës së Futbollit nga dy asociacionet ndërkombëtare. Sa i përket një kriteri shumë të rëndësishëm, licencimit të klubeve, këtu Federata e Futbollit ka shumë punë dhe ne e ftojme edhe një herë federatën që ta përshpejtojë, bashkë me klubet,

dorëzimin e aplikacioneve të klubeve sepse licencimi nuk e përfshin vetëm federatën si strukturë administrative dhe menaxhuese, por të gjitha klubet që bëjnë pjesë në garat zyrtare të federatës", ka thënë Çeku në konferencë për shtyp. "Ne jemi në komunikim edhe me UEFA-n, edhe me FIFA-n. I kemi kërkuar disa sqarime nga to sa i përket statutit të ri të FFK-së dhe disa aspekte të tjera që kanë të bëjnë me kriteret ndërkombëtare për licencim. Kur t'i marrim përgjigjet nga FIFA dhe UEFA do të kemi më shumë qartësi në raport me licencimin e FFK-së", ka shtuar Çeku.

Numri një i MKRS-së, Hajrulla Çeku, foli edhe për gjendjen në stadiumin "Adem Jashari". Ai ka theksuar se çështja e



shpronësimit është në rrugë të mirë dhe se, pasi të mbyllet ajo, do të nisë renovimi i këtij stadiumi, i cili ka përfunduar në një gjendje të mirë, pak vite pasi aty ishte zhvilluar ndeshja e parë

ndërkombëtare pas lejes së dhënë nga FIFA. "Projekti i stadiumit, rinovimi i stadiumit 'Adem Jashari' në Mitrovicë është në fazën e fundit të rregullimit të çështjes së shpronësimit dhe

këtu jemi duke punuar bashkë me ministrin Aliu për ta përmbyllur një çështje problematike që do të duhej të ishte përmbyllur para se të fillonte ky projekt. Për fat të keq, projekti ka nisur pa u qartësuar çështja e pronave, por besoj se shumë shpejt do të përfundojë kjo çështje e shpronësimit dhe punimet do të rifillojnë, sepse operatori tashmë është në kontratë lidhur me Ministrinë dhe është në pritje të zgjidhjes së çështjes së shpronësimit. Unë jam i bindur që shumë shpejt do ta përmbyllim këtë çështje të shpronësimit dhe kjo i bie autorizim për operatorin me të cilin jemi në komunikim të përhershëm për t'i vazhduar punimet e renovimit të stadiumit 'Adem Jashari'", ka shtuar Çeku.

Ferizaj mposhti Llapin, fitojnë Trepça '89 dhe Dukagjini



"Epoka e re"

FERIZAJ, 8 MARS - Të mërkurën janë zhvilluar tri ndeshje të javës së 24-t në Albi Mall Superligën e Kosovës. Skuadra e Ferizajt ka shënuar një fitore të madhe në përballje me skuadrën e Llapit (2-1). Mysafirët kaluan të parët në epërsi me golin e Gerhard Prognit në minutën e 11-të, por kjo nuk i ndali futbollistët e Ferizajt që ta kërkojnë përmbysjen e rezultatit që e

arritën në këtë ndeshje. Në minutën e fundit të pjesës së parë, Edon Sadriu realizoi një gol të bukur për t'i barazuar shifrat në 1-1. Edon Sadriu ishte hero i vendësve, kur në minutën e 59 shënoi pas një asistimi të bukur nga Betim Haxhimusa për rezultat final 2-1. Fitore të madhe ka realizuar edhe Dukagjini që ka mposhtur në udhëtim Malishevën me rezultat 1-2. Khomutov dhe Marceli Santos realizuan golat për skuadrën klinase, ndërkohë Bihorac ishte shënuesi i vetëm

për Malishevën. Tri pikë të mëdha në udhëtim i ka arkituar edhe Trepça '89 që ka mposhtur Drenicën me rikthim 1-2. Da Silva i kaloi i pari vendasit në epërsi me golin në minutën e shtatë, ndërsa rezultati u barazua në minutën e 32-të me autogolin që realizoi Shkëlzen Lushtaku 1-1. Golin e fitores për skuadrën mitrovicase e shënoi Rilind Nimani në minutën e 56 nga gjuajtja e lirë. Nesër zhvillohen edhe dy ndeshjet e tjera. Do të përballën Ballkani - Drita dhe Gjilani - Prishtina.

Futbollisti i Lirisë ftohet nga Namibia

Prizren, 8 mars - Prins Tijueza po shkëlqen me paraqitjet e tij te Liria, duke i bërë për vete adhuruesit e klubit bardhezi. Sulmuesi anësor ka shënuar gjashtë gola, derisa ka dhuruar edhe disa asistime dhe në të janë shkaktuar edhe penallti. Këto paraqitje kanë bërë që 20-vjeçari

të ftohet nga Namibia për ndeshjet kualifikuese për Kupën e Afrikës, me Kamerunin më 23 e 28 mars. "Ftesa e tij në reprezentacion tregon shumë qartë çfarë futbollisti kemi në skuadër", ka shkruar Liria. Futbollisti në fjalë ka deklaruar se ka synim me Lirinë të kthehet në

Superligë. "Tashmë synimi vetëm është që me klubin Liria të kthehem në Superligë. Këtu ka një organizim të mirë. Po kaloj shumë bukur me shokët e skuadrës. Po ashtu, publiku e do futbollin. Shpresoj që bashkërisht ta arrijmë objektivin, kthimin në Superligë", ka deklaruar Tijueza.



Shefi i Ferrarit: Një garë e keqe nuk mund ta ndryshojë sezonin tonë

ROMË, 8 MARS - Frederic Vasseur, shefi i Ferrarit, kërkon t'i qetësojë tifozët pas zhgënjimit të "kokëkuqes" në garën e parë sezonale të Formulës 1 zhvilluar në Bahrein. Makina italiane arriti një vend të katërt me spanjollin Carlos Sainz,

ndërsa njëvendëshja e Charles Leclerc u tërhoq në mesin e garës, kur ndodhej në vendin e tretë. "Ajo që ndodhi në Bahrein nuk do ta ndryshojë sezonin tonë. Po analizojmë me kujdes gjithçka për të kuptuar më shumë në lidhje me makinën

tonë dhe me rivalët. Sezioni sapo ka nisur, të mos nxjerrim përfundime të gabuara, vetëm duke u bazuar në një garë", ka thënë Vasseur. Duke analizuar paraqitjen e "kokëkuqes" në Bahrein, francezi shton: "Në pjesën e parë të garës ishim më

pranë Red Bullit sesa ndaj Aston Martinit. Situata mund të ndryshojë për mirë pas dy javësh, në garën e radhës në Jeddah. Edhe Mercedesi do të zgjohet, ndaj do të kemi një paraqitje ndryshe nga skuadrat".



Sylvinho: Shqipëria do të ketë emra të rinj, takova Brojën në Londër

TIRANË, 8 MARS - Kualifikueset për "Euro 2024" po afrohen dhe te Shqipëria do të nisin shumë shpejt përgatitjet. Kuqezinjtë kërkojnë të bëjnë një fazë eliminatore pozitive, për të siguruar kështu një biletë për në Evropian. Vëmendja është te trajneri i ri i kuqezinjve, Sylvinho, i cili ka filluar të mendojë për emrat që do të ftojë në listë. "Po, do të ketë emra të rinj. Prej dy muajsh këtu kam parë ndonjë ndeshje dhe mund të them që lojtarë të mirë ka gjithandë, por nuk dua të përmend emra. Është një lojtar te Partizani i cili më pëlqen shumë. E kam ndjekur disa herë dhe them se teknikisht mund të zhvillohet edhe më shumë. Te Partizani ka luajtur edhe Skuka i cili tashmë ka shkuar jashtë. Gjithmonë ka lojtarë dhe ne duhet t'i shohim, ndaj vendosa të jetoj këtu. Mendova që punën ta zhvilloja këtu. Puna nis nga këtej dhe theksoj që kam të evidentuar 2-3 lojtarë këtu të cilët, ndoshta, në të ardhmen mund të zhvillohen dhe të bëhen lojtarë të mëdhenj", ka thënë Sylvinho në një intervistë për "RTSH".

Ai u ndal edhe te fakti që Shqipëria në këtë moment ka disa lojtarë të rëndësishëm të dëmtuar dhe shpjegoi se kishte shkuar të



takonte personalisht lojtarë si Armando Broja apo Ardiën Bajrami për t'u treguar se ishin pjesë e planeve të tij kur të ktheheshin në fushën e lojës. "Për fat të keq, në futboll ndodh edhe dëmtimi. Është një moment i vështirë për futbollistët. Kur nisa punën rreth dy muaj më parë, mendova të bëj një rrugëtim të gjatë për të takuar lojtarë të shpërndarë në Evropë, të tjerë i kam kontaktuar në telefon. Mendova se në 2-3 raste duhet të shkoja e takoja e të flisja nga afër me ta, sepse doja t'u tregoja rëndësinë që kanë për ne, edhe pse nuk do të jenë në listë. Dëshiroja t'i përqafoja se personalisht e di shumë mirë që një lojtar që qëndron 2-3 muaj

jashtë, e ka shumë të vështirë. Armando Broja është një nga të dëmtuarit që kam shkuar të takoj, është i dëmtuar dhe si ai ka edhe disa të tjerë. Kam qenë edhe në Portugal për një lojtar. Kam biseduar me ta dhe e vetmja gjë që mund të them është se i kemi dhënë forcë dhe i kemi thënë se e ka të gjithë mbështetjen tonë dhe federatës për t'i kaluar këto çaste. Nuk është e lehtë, nuk i kam takuar për çështje teknike apo taktike, por thjesht për t'i përshëndetur dhe për t'u takuar. Kam folur edhe me Uzunin dhe me shumë të tjerë. Uzuni po kalon një moment shumë të mirë, por kemi shumë lojtarë të tjerë të fortë që po bëjnë mirë dhe këtë e them me bindje", ka deklaruar Sylvinho.

Milwaukee mbetet lider në Lindje, Lakersat fitojnë e synojnë 'play off'-in

LOS ANXHELOS, 8 MARS - Ekipi i Milwaukee nuk lëshon kreun e renditjes në Lindje, duke mposhtur me rezultat 134-123 Orlandon jashtë fushës. Lopezi me 26 pikë, Middleton e Carteri me nga 24 pikë secili, zëvendësuan mirë Antetokounmpo, që nuk luajti për Bucksin. Fiton edhe Dallasi, që falë 33 pikëve të



Irvingut e 29 të Donçiqit, mposhti me rezultat 120-116 Utah Jazzin, në një ndeshje të fortë deri në fund. Fitore të rëndësishme që e fut në zonën e "play-out"-it arritën lakersat, që mundën me rezultat 112-103 Memphisin. Mbrëmje magjike e Anthony Davisit, autor i

30 pikëve e 22 reboundeve, lider në parket për lakersat. Fitorja e tretë radhazi për Philadelphian, që falë 39 pikëve të Embiidit dhe 27 të Maxeyt, mposhti me rezultat 117-94 Minnesotan dhe ngjitet në vendin e tretë në Konferencën e Lindjes.

REZULTATET

Detroit - Washington	117-119
Orlando - Milwaukee	123-134
Minnesota - Philadelphia	94-117
New York - Charlotte	105-112
Houston - Brooklyn	96-118
Oklahoma - Golden State	137-128
Dallas - Utah Jazz	120-116
Lakers - Memphis	112-103

Koulibaly: E dua finalen Chelsea - Napoli

Pas kualifikimit në çerekfinale të Ligës së Kampionëve me Chelsea, Kalidou Koulibaly foli për "Sky Sport". Ai hipotezoi një kryqëzim të mundshëm të rrugëve në kompeticionin më të

rëndësishëm të klubeve evropiane midis Chelseat dhe Napolit. "Shpresoj ta takoj ish-skuadrën time sa më lart që të jetë e mundur, ndoshta në finalen e Stambollit. Gjithashtu e uroj Napolin që të shkojë sa

më përpara në Ligën e Kampionëve. Do doja shumë të përballëshim në finale", ka thënë Koulibaly. Blutë e Londrës e siguruan vendin në çerekfinale pasi përmbysën disavantazhin 1-0 të ndeshjes së parë në

fushën e Borussia Dortmundit. Rezultati i përgjithshëm 2-1 avancoi më tej skuadrën londineze. "Ishte pak e vështirë. E dinim që kjo ndeshje ishte thelbësore për ne. Donim ta fitonim me çdo kusht.

Zhvilluam një lojë të shkëlqyeshme, me intensitetin e duhur. E përsëris: donim të fitonim me çdo kusht dhe ia dolëm. Tani mund të jemi të lumtur", ka shtuar Koulibaly.

SHKURT

Vlera e Mirlind Dakut është 800 mijë euro

Mirlind Daku është emri i sulmuesit që po përflitet shumë në mediet e Shqipërisë dhe Kosovës për një kalim të mundshëm nga ekipi 'dardan' tek ai kuqezi. Ende nuk dihet saktë, por duket se ish-lojtari i Ballkanit dhe shumë skuadrave të tjera në Superligën e Kosovës në të ardhmen e afërt do ta bartë fanellën e Shqipërisë. 25-vjeçari luan në Sloveni te skuadra e NS Mura dhe gjatë këtij sezoni ai ka statistika fantastike. Ka shënuar 13 gola dhe ka bërë një asistim. Vlera e tij momentale, sipas sajtit të njohur "Transfermarkt", shkon deri në 800 mijë euro. Por, përditësimi është afër dhe vlera e tij mund të shkojë deri në 1.5 milion euro. Kujtojmë që Daku ka bërë pesë paraqitje me ekipin e Kosovës, por ato ishin vetëm ndeshje miqësore dhe ka të drejtën të bëjë lëvizje te Shqipëria.

Ten Hagen miraton shitjen e dyshes Maguire - Martial

Trajneri i Manchester Unitedit, Erik ten Hag, është gati të arkëtojë para nga shitja e dy lojtarëve të ekipit të parë këtë verë. Shumë ekspertë financiarë besojnë se Djajtë e Kuq duhet të shesin për të financuar blerje të reja sikurse ato që përjetuan verën e fundit. Sipas mediumit "talkSPORT", trajneri Ten Hag do t'i lehtësojë shqetësimet e "fair-play financiar" duke shitur dy yjet: Harry Maguire dhe Anthony Martial. Holandezi është gati ta lejojë largimin e dyshes, ndërkohë që edhe lojtarë të tjerë të ekipit të parë mund të jenë në rrezik nëse vijnë oferta të mira. Unitedi do të ndjekë një qendërsulmues, një mesfushor qendror dhe, ndoshta, një qendërmbrojtës rezervë gjatë verës.

Xavi: Vazhdimi i kontratës pas fitimit të trofeve

Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, ka saktësuar se do ta rinovojë kontratën e trajnerit Xavi Hernandez. Pas deklaratës së Laportës ka ardhur edhe reagimi i trajnerit të katalanasve. "Fakti që klubi dëshiron të më ofrojë një kontratë të re më bën të ndihem mirë, sepse është një shenjë besimi që ata kanë tek unë dhe puna ime. Por përpara se të arrijmë deri aty, ne duhet të fitojmë trofe në këtë sezon. Nëse do t'ia dalim, mendoj se do të jemi në pozita komode për ta vijuar projektin", ka thënë Xavi. Barça kryeson garën në La Liga dhe ndodhet në gjysmëfinale të Kupës së Mbretit, teksa deri më tani ka fituar një trofe, Superkupën e Spanjës.

Milionat e sheikëve joshin Modriqin dhe Kroosin

Dy ikonat e Real Madridit, Toni Kroos dhe Luka Modriq, janë në përfundim të kontratës, ndërsa e ardhmja e tyre është e gjitha për t'u përcaktuar. Sipas medieve spanjolle, përfaqësuesit e dy lojtarëve do të takohen me drejtuesit e klubit për ta diskutuar mundësinë për rinovimin e kontratës e cila u përfundon në fund të këtij sezoni. Në lidhje me Luka Modriqin, zërat flasin se kroati pritet të largohet në fund të këtij sezoni, pasi oferta e ardhur nga Al Nassr po e josh gjithnjë e më shumë. Diskutimi është pak më ndryshe për mesfushorin gjerman i cili fillimisht dëshiron ta dëgjojë ofertën e Real Madridit për të vendosur më pas për të ardhmen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT


SWISS TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitim Mackaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl: VI - IX SHFMU "Mic Sokoli" Lubiqevë.

+37744162783 dhe 049/900-994.

NaserMackaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl: VI - IXSHFMU "Mic Sokoli" Lubiqevë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

Rita Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues